



KUSH JEMI NE

EULEX Kosovo ka filluar punën në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të **Bashkimit Evropian** për Siguri dhe Mbrojtje. Misioni i tij është të mbështesë institucione të përzgjedhura të **sundimit të ligjit** të Kosovës në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumë-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira prej ndërhyrjeve politike dhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikën evropiane më të mira.



ÇKA BËJMË NE

EULEX-i e zbaton mandatin përmes Shtyllës për Monitorim dhe Shtyllës për Mbështetje të Operacioneve. Misioni është i përkushtuar që ta përmbush obligimin e tij për **përfshirjen e aspektit gjinor dhe të drejtave të njeriut** në të gjitha aktivitetet e tij, si në kuadër të Misionit ashtu edhe gjatë punës me institucionet e Kosovës.



Fakte të shpejta

Shefi i Misionit:

Giovanni Pietro Barbano nga Italia



14 qershor 2023 – 14 qershor 2025



≈ 400 staf vendas dhe ndërkombëtar



Prishtinë, Kosovë

Baza ligjore:

- Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/1095
- Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës shkurt 2008
- Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999)



EULEX-i mbështetet nga:



dhe



[eulex.kosovo](https://www.facebook.com/eulex.kosovo)



[eulexkosovo](https://twitter.com/eulexkosovo)



[EULEXKosovo](https://www.youtube.com/EULEXKosovo)



www.eulex-kosovo.eu



press@eulex-kosovo.eu
info@eulex-kosovo.eu

European Union
Rule of Law Mission
Partnership for justice


EULEX
European Union Rule of Law Mission
Kosovo

SHTYLLA PËR MONITORIM

EULEX-i bënë vlerësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë të Kosovës në aspektin e përputhshmërisë **procedurale, ligjore dhe të drejtave të njeriut** përmes monitorimit të rasteve të përzgjedhura përgjatë tërë zinxhirit të sistemit të drejtësisë penale, që përfshinë në nivelin policor, prokurorial, dhe gjyqësor.

Nga qershori 2018 deri më 14 qershor 2023, monitoruesit e EULEX-it për drejtësi kanë vijuar

1940

seanca gjyqësore

për

330

raste aktive penale dhe civile

që përfshijnë raste të profilit të lartë, raste të krimeve të luftës, raste të dhunës në baza gjinore, raste të korrupsionit dhe raste që janë trajtuar nga EULEX-i në të kaluarën. Ky monitorim rezulton me raporte ku prezantohen gjetje dhe rekomandime për autoritetet e Kosovës me qëllim të përmirësimit të sistemit të drejtësisë.

EULEX-i mbështetë angazhimet e Shërbimit Korrektues të Kosovës për zhvillimin e ekipit menaxherial profesionist përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. Që nga viti 2021, EULEX-i e mbështetë edhe Shërbimin Sprovues të Kosovës.

15 QERSHOR 2018 **14 QERSHOR 2023**

Stafi i Njësisë Korrektuese të EULEX-it:

kanë kryer mbi **800 vizita në teren** në institucione të ndryshme korrektuese dhe në zyra rajonale të sprovimit



kanë mbajtur rreth **665 takime** me stafin e **Shërbimit Korrektues të Kosovës** dhe **69 takime** me stafin e **Shërbimit Sprovues të Kosovës** në selitë e tyre për të mbështetur menaxhmentin në adresimin e çështjeve strategjike



Kanë mbështetur trajnime për rreth **1830 pjesëmarrës**



SHTYLLA PËR MBËSHTETJE TË OPERACIONEVE



Njësia Policore e Specializuar e EULEX-it është **reaguesi i dytë i Kosovës** në fushën e sigurisë, duke qenë pjesë e një mekanizmi treshresor të reaguesve në fushën e sigurisë. EULEX-i mund të angazhohet vetëm me kërkesë specifike të reaguesit të parë të sigurisë me qëllim që të kontribuoj në ruajtjen dhe avancimin e rendit dhe sigurisë publike në raste të trazirave qytetare.



Kryen patrullime të përditshme të vëzhgimit për t'u informuar mbi situatën

15 qershor 2018 - 14 qershor 2023
Ushtime për kontrollimin e turmave dhe trazirave



10 trajnime me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in



11 trajnime me Policinë e Kosovës



70 trajnime me KFOR-in

BASHKËPUNIMI POLICOR NDËRKOMBËTAR

EULEX-i e lehtëson shkëmbimin e informatave mes Policisë së Kosovës dhe Interpolit, Europolit apo Ministrisë së Brendshme të Serbisë.

Kërkesat e pranuar dhe të dërguara nga EULEX-i prej 15 qershor 2018 deri më 14 qershor 2023



10130

(përmes Zyrës Ndërlidhëse të Interpolit në UNMIK)



1695



2731

EULEX-i vazhdon të menaxhojë programin e tij për mbrojtjen e dëshmitarëve.



EKSPERTË TË EULEX-it

punojnë bashkë me homologët vendas në

INSTITUTIN E MJEKËSISË LIGJORE



për gjetjen e fatit të personave të zhdukur

përmes ofrimit të ekspertizës dhe këshillave



2009

14 qershor 2023

MISIONI KA KRYER:

736

operacione në teren për gjetjen e personave të zhdukur

Përfshirë

198

zhvarrime

Mbetjet mortore të

491

individëve janë identifikuar

Përfshirë

339

persona të zhdukur



Misioni i asiston Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës me mbështetje logjistike dhe operacionale në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.